



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 88 Prot.

Tiranë, më 06.05.2025

V E N D I M

Nr. 116 , Datë 06.05.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.253 Regj., datë 17.12.2024, me palë ankuese z. S. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës, me pretendimin se është diskriminuar për shkak “të aftësisë së kufizuar”.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankuesi parashtron se: *Jam bërë pronar i një automjeti me karakteristika sipas dokumentacionit bashkëngjitur, automjet ky që vjen nga Republika e Koresë dhe ka hyrë në portin e qytetit të Durrësit më datën 15.11.2024. Duke qenë person me statusin e të verbrit, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 (i ndryshuar), në të cilin thuhet shprehimisht se: “të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë”, si dhe pika 3, shkronja ll të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “ll) mallrat për organizata bamirësie ose filantropike; artikujt e destinuar për të verbërit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara”, i jam drejtuar Degës së Doganës Durrës me kërkesë për përjashtim nga pagimi i taksës doganore.*

Më datën 29.11.2024, Dega e Doganës Durrës ka refuzuar kërkesën time me arsyetimin se automjetet nuk përbëjnë objekt përjashtimi nga pagimi i taksës doganore në rastin e personave që gëzojnë statusin tim. Për këtë, referohem akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim të Kodit Doganor, konkretisht VKM nr. 651, datë 10.11.2027, dhe udhëzimit përkatës të nxjerrë në bazë të

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

zbatimit të tij, aktet nënligjore që kufizojnë llojet e mallrave për të cilat aplikohet përjashtimi, në shkëlqje të nenit 4 të Statusit të të Verbërit dhe në tejkallim të nenit të lartpërmendur të Kodit Doganor, i cili nuk bën specifikime. I ndodhur në këto rrethana, jam detyruar të paguaj taksën doganore në shumën 126,984 lekë.

Ndërkaq, bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, personat që gëzojnë këtë status përjashtohen nga çdo lloj takse të drejtpërdrejtë, me kusht që të mos ushtrojnë veprimtari ekonomike. Ndryshe nga personat me statusin e të verbrit, personat me statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik përfitojnë përjashtimin nga pagimi i taksës doganore mbi automjetet.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dega e Doganës Durrës, dhe kthimin e shumës së paguar prej 126,984 lekë.

Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankueses me shkresën nr.1672/1 prot., datë 23.12.2024, ku kërkohet informacioni i mëposhtëm:

- Kopje të lejes së drejtimit që ju është dhënë në cilësinë e personit me aftësi të kufizuar (AK) nga institucioni përkatës.
- Kopje të lejes së qarkullimit të mjetit që ka të shënuar faktin se ky mjet shërben për të lëvizur persona me aftësi të kufizuar.
- Informacion nëse automjeti ka shenjën dalluese që përdoret për persona me aftësi të kufizuar.
- Kopjen e ankesës së bërë nga ana juaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega Durrës, ku e keni adresuar këtë problematikë, e shoqëruar me dokumentacionin provues të pretendimeve tuaja.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Sa më sipër, nga ana e ankuesit me email e datës 08.01.2025 është kthyer asnjë përgjigje dhe janë dhënë sqarime përsa u kërkuan nga ana e Komisionerit me shkresën nr. 1672/1 prot., datë 23.12.2024.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të LMD, ku parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 88 prot., datë 13.01.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Degës së Doganës Durrësit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që të japin parashtrimet e tyre sipas kompetencës, përgjegjësisë ligjore dhe dokumentacionit respektiv që disponojnë lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Dega e Doganës Durrësit, me shkresën³ Nr. 791/1 prot., datë 21.01.2025, vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrimet sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se: Z. S. P., me NIPT/ID G708270511, ka aplikuar përmes portalit qeveritar E-Albania, me nr. aplikimi DPD-2024-00036733, me lëndë “Autorizim përjashtimi nga detyrimet doganore”, me qëllim përjashtimin nga pagimi i detyrimeve të importit për automjetin e importuar prej tij.

Dega e Doganës Durrës, pasi verifikoi dokumentacionin shkresor të depozituar nga Z. S. P., vendosi refuzimin e aplikimit me shkresën nr. aplikimi DPD-2024-00036733, datë 29.11.2024, me arsyetimin

³ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 88/1 prot., datë 23.01.2025.

se, citojmë: Bazuar në Ligjin Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe VKM-në Nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 03.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi Operacionet e Privileguara”, dhe nenet 470, 471 të VKM-së Nr. 651, datë 10.11.2017. Aplikimi juaj refuzohet, pasi automjetet nuk përjashtohen për personat në statusin tuaj.

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga Z. S. P., me Nr. ID (G708270511), ju bëjmë me dije se ato nuk qëndrojnë, pasi legjislacioni aktualisht në fuqi nuk parashikon kategorinë e personave me statusin e të verbërve për përjashtim nga pagimi i detyrimeve të importit lidhur me automjetet.

Në nenin 184 të Kodit Doganor, si dhe në Vendimin Nr. 651, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave, në nenet 470 dhe 471 të tij, është përcaktuar kategoria e artikujve që përjashtohen dhe që janë për përdorim nga të verbrit, si dhe kushtëzimet përkatëse, citojmë se:

Neni 470 “Artikujt për përdorim nga të verbrit”

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 11 të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 471 “Kushtëzime”

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 12 të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga: a) Vetë personat e verbër për nevojat e tyre; ose b) Institucione apo organizata që merren me edukimin apo dhënien e ndihmës për persona të verbër, të cilat janë të autorizuar nga autoritetet doganore kompetente të marrin këta artikujt me përjashtim nga detyrimet e importit.
2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1 zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesë përbërëse apo pjesët ndihmëse përkatëse të artikujve në fjalë, si dhe për veglat që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse, pjesë ndihmëse apo veglat të jenë importuar në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë, ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato mund të identifikohen se janë të destinuar për artikujt që janë lejuar më parë me përjashtim nga detyrimet e importit, ose të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtim i tillë kërkohet për pjesët specifike të këmbimit, rezervës, komponentëve apo pajisjeve ndihmëse dhe veglave në fjalë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe Udhëzimit Nr. 01, datë 03.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi Operacionet e Privileguara”, kategoritë përfutuese për përjashtimin nga pagimi i detyrimeve në import për automjete deri në 2500 kubikë, të përshtatura për përdorimin e tyre, janë invalidët tetraplegjikë dhe paraplegjikë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën⁴ Nr. 759/1 prot., datë 24.01.2025, vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrimet sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, është agjenti për taksat dhe përgjegjëse për llogaritjen dhe arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura dhe të luksit.

Referuar germës "ç" të nenit 9 të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, parashikohet: "Përjashtimi nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura: Autoveturat tip deri në 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve dhe të veteranëve të luftës kundërpushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private."

Për invalidët e punës, personat e verbër, të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe personat me aftësi të kufizuara, për përjashtimin nga TVMP-ja, çdo vit përjashtimi bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të qytetarit me status "invalid", dhe duhet që:

i. Dosja e mjetit e qytetarit me status "invalid" dhe dosja e invaliditetit e tij duhet të jenë nën juridiksionin territorial të drejtorisë rajonale ku ka vendbanimin qytetari me status "invalid", sipas regjistrimit të gjendjes civile. ii. Të jetë i pajisur me librezën e invaliditetit, lëshuar nga Shoqata e Invalidëve, në zbatim të nenit 4 të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", i ndryshuar, ose librezën e verbërisë, ose librezën e paraplegjikut/tetraplegjikut lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. Pas verifikimit të vlefshmërisë së këtyre dokumenteve, fotokopja e tyre mbahet nga strukturat e DPSHTRR-së. iii. Vërtetim të KMCAP-it, i siguar nga vetë qytetari me status "invalid", nëpërmjet portalit e-Albania, kjo në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.09.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", ose vërtetimin origjinal të KMCAP-it ose i noterizuar, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën përkatëse të invaliditetit, ose kopje e vendimit të Komisionit të Përcaktimit të Verbërisë, lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë KMCAP-it për personat e verbër, pasi të verifikohet origjinali. iv. Vërtetimin, i siguar nga vetë qytetari me status "invalid", nëpërmjet portalit e-Albania, në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 13.09.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", që tregon se qytetari nuk zhvillon aktivitet privat. v. Kartën e identitetit të vlefshme të personit me status "invalid" që ka në pronësi mjetin.

Më poshtë gjeni përgjigjet në lidhje me pikat që DPSHTRR disponon informacion:

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 88/1 prot., datë 23.01.2025.

Pika 4

Informacion dhe statistika lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara që rezultojnë të regjistruar si përdorues të mjeteve (automjeteve). Nga verifikimi në regjistrin Kombëtar të mjeteve dhe sistemin informatik e-DPSHTrR rezulton se përgjatë vitit 2024 janë përjashtuar nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura rreth 18,000 qytetarë të cilët gëzojnë statusin invalid, me kohë të pjesshme dhe të plotë.

Pika 8

A janë të përjashtuar të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara nga taksa e regjistrimit të automjeteve? Nëse po, parashtrimet tuaja dhe mbi çfarë baze ligjore është bërë një parashikim i tillë? Nëse jo, argumentimi juaj dhe cilat kategori të personave me aftësi të kufizuara (dhe numri), specifikisht, janë të përjashtuara nga kjo taksë?

Në zbatim të germës c) dhe gj) të nenit 5 të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, DPSHTRR ngarkohet: c) për vjeljen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura (për të cilën invalidët janë të përjashtuar); gj) për vjeljen e taksës së regjistrimit fillestar për automjetet luksoze dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze (për të cilën invalidët nuk janë të përjashtuar).

2. Me anë të shkresës nr. 88/3 prot., datë 11.02.2025, Komisioneri, duke u bazuar në faktin që nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ishte dërguar asnjë informacion, kërkoi dërgimin e tij.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën⁵ nr. 542/1 prot., datë 10.02.2025, informoi Komisionerin ndër të tjera se:

Ligji nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton shkallët e TVSH-së, si dhe llojet e shërbimeve që janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Në klasifikimin e shkallëve, ligji ka përcaktuar shkallën standarde prej 20%, ndërsa disa furnizime shërbimesh/mallrash i nënshtrohen shkallës së reduktuar të TVSH-së prej 6% ose 0%.

Gjithashtu, përveç shkallëve tatimore, ligji ka parashikuar në mënyrë eksplicite llojet e shërbimeve/mallrave të cilat janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Në nenin 50 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: "Shkalla e TVSH-së, e aplikueshme për importimet e mallrave, është ajo që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë për shitjen e të njëjtit mall."

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 88/4 prot., datë 12.02.2025.

Referuar kësaj dispozite, importi i mallrave në doganë ka të njëjtën trajtim tatimor dhe i nënshtrohet të njëjtës shkallë TVSH-je sikurse është shitja e tyre brenda territorit. Pra, nëse për një mall që shitet brenda vendit është e aplikueshme shkalla tatimore 6%, atëherë në import do të aplikohet e njëjta shkallë.

Përsa u takon furnizimeve të përjashtuara, ligji i ka përcaktuar ato shprehimisht në nenet 51 dhe 53 të tij, ku ka renditur në mënyrë eksplicite një sërë shërbimesh me interes të përgjithshëm dhe furnizime mallrash.

Referuar këtyre dispozitave ligjore, gjejmë të renditur si mallra të përjashtuar në nenin 51, pikën “p”, vetëm automjetet me motor elektrik, të reja, me zero kilometra, dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër.

Pra, nëse furnizimet për automjetet për të verbërit brenda vendit do të ishin të përjashtuara nga TVSH-ja, kjo do të ishte shprehur në dispozitat e nenet 51 ose 53 dhe, si rrjedhojë, do të ishin të përjashtuara edhe në import.

Më tej, në nenin 56 të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë përcaktuar përjashtimet e veçanta në import, të cilat nuk janë të renditura si përjashtime brenda vendit, por janë vendosur tek dispozita e cila ka vetëm përjashtimet e veçanta në import. Konkretisht, janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import: “Mjete të posaçme që përdoren për edukimin, trajnimin, punësimin ose për nevoja të personave të verbër dhe të shurdhër ose personave të tjerë me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, nëse janë siguruar falas dhe importohen nga institucionet apo organizatat, aktiviteti i të cilave është edukimi dhe asistenca për këta persona, të kryera për qëllime jotregtare nga donatorët.”

Sa më sipër, për të qenë mjete të përjashtuara në import, ato duhet të jenë për nevoja të personave të verbër, të siguruara falas dhe të importuara nga institucionet apo organizatat, aktiviteti i të cilave është edukimi dhe asistenca për këta persona, të kryera për qëllime jotregtare nga donatorët.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar sipas Librezës nr.21641 të Shërbimit Social Shtetëror se, z. S. P., është person me aftësi të kufizuara dhe i përket kategorisë së personave përfitues të statusit të të verbërit.

Sa më sipër, rezulton se z. S. P., me NIPT/ID G708270511, ka aplikuar përmes portalit qeveritar E-Albania, me nr. aplikimi DPD-2024-00036733, me lëndë “Autorizim përjashtimi nga detyrimet doganore”, me qëllim përjashtimin nga pagimi i detyrimeve të importit për automjetin e importuar prej tij.

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës, pasi ka verifikuar dokumentacionin shkresor të depozituar nga z. S. P., ka vendosur refuzimin e aplikimit me shkresën nr. aplikimi DPD-2024-00036733, datë 29.11.2024, me arsyetimin se bazuar në Ligjin Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe VKM-në Nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 03.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi Operacionet e Privileguara”, dhe nenet 470, 471 të VKM-së Nr. 651, datë 10.11.2017, aplikimi refuzohet, pasi automjetet nuk përjashtohen për personat në statusin e verbërit.

Pala ankuese pretendon diskriminim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës dhe ka parashtuar një kërkesë për përjashtim nga pagimi i taksës doganore mbi një automjet të cilin ai ka importuar nga Republika e Koresë, duke u bazuar në statusin e tij si person me aftësi të kufizuara, përkatësisht si person i verbër. Për këtë arsye, ankuesi ka apeluar për përjashtim nga taksat doganore, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për Statusin e të Verbërit” i ndryshuar, dhe në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë, të cilat parashikojnë përjashtimin nga taksat për artikujt që janë për të verbrit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Kërkesa e ankuesit është refuzuar nga Dega e Doganës Durrës me arsyetimin se automjetet nuk përbëjnë objekt përjashtimi nga pagimi i taksës doganore për individët me statusin e të verbrit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të zbatuara.

Ankuesi, pretendon se shkak i diskriminimit është aftësia e kufizuar, pra arsyeja për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit ai i është nënshtruar, konkretisht është aplikimi i pagesës së taksës doganore për individët me statusin e të verbrit, si pasojë e faktit që ankuesi ka aftësi të kufizuara.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

⁶ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me përjashtin nga taksa doganore për blerjen e automjetit të tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës.

Legjislacioni i zbatueshëm

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁷

Neni 1 “Qëllimi”

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojtë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

Neni 2 “Përkufizimet” Në kuptimin të kësaj Konvente:

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Neni 3 “Parime të përgjithshme”

refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”

⁷ Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

Parimet e kësaj Konvente do të përfshijnë: (a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit; (b) Mosdiskriminimin; (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri; (d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit; (e) mundësi të barabarta; (f) Akses; (g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave; (h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 4 “Detyrime të përgjithshme”

1. Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuara. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin përsipër: (a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë; (b) Të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative për të modifikuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikën ekzistuese, të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara; (c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha politikën dhe programet; (d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë Konventë dhe të sigurohen që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë Konventë; (e) Të marrin të gjitha masat e duhura...3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese. 4. Asgjë nga kjo Konventë nuk duhet të prekë ato dispozita, që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe që mund të përmbahen në ligjin e Shtetit Palë apo ligjin ndërkombëtar në fuqi për atë Shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cënim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njohura apo ekzistuese në cilindo Shtet Palë në këtë Konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo Konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri, apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

Neni 5 “Barazia dhe mosdiskriminimi”

1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji. 2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuara dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë. 3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimit të diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshëm. 4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.

Ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në nenin 3, pika 1, ka përcaktuar se: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika””.

Ligjit Nr. 102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 184 “ Rastet e përjashtimeve dhe kushtet”

3.Përjashtime nga detyrimi i importit jepet edhe në rastet e: ll) mallrave për organizata bamirësie ose filantropike; artikuj të destinuar për të verbrit dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara;

Ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”

Neni 56 “Përjashtime të veçanta në import”

Janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import: 27. Importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar

Neni 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

Neni 4

Të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

Sa më sipër, autoritetet doganore shqiptare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mallrat i klasifikojnë sipas një sistemi ndërkombëtar të quajtur **HS Code** (*Harmonized System Code*), i miratuar nga Organizata Botërore e Doganave⁸. Ky sistem përdor një kod prej 6-10 shifrash për të identifikuar saktësisht llojin e mallit. Në Shqipëri, përdoret Sistemi i Kombinuar (në përputhje me BE-në).

⁸ <https://www.wcotradetools.org/en/harmonized-system/text/international-convention-commodity-description-and-coding-system>

Taksat doganore⁹ nuk kanë një emërtim unik, por emërtohen sipas funksionit dhe mënyrës së aplikimit të tyre, si më poshtë:

1. Taksë doganore (tarifë doganore) – Taksa standarde që aplikohet mbi mallrat që importohen, sipas tarifës doganore në fuqi.
2. Taksë ad valorem – Emërtohet si e tillë sepse llogaritet në përqindje mbi vlerën e mallrave, sipas nenit përkatës të Kodit Doganor.
3. Taksë specifike – Emërtohet sipas njësisë së sasisë fizike të mallit (kg, litër, copë, etj.).
4. Taksë e kombinuar – E nominuar si kombinim i dy mënyrave të mësipërme.
5. Taksë anti-dumping – Emërtohet kështu kur aplikohet ndaj importeve që dëmtojnë prodhimin vendas për shkak të çmimit më të ulët se kostoja reale.
6. Taksë kompensuese – Aplikohet për të neutralizuar subvencionet që vendet e tjera i japin eksportuesve të tyre.
7. Taksë mbrojtëse (safeguard) – Përkohësisht, për të ruajtur interesin e prodhuesve vendas nga rritje të papritura të importeve.
8. Taksë preferenciale – Aplikohet për vendet që kanë marrëveshje tregtare me Shqipërinë (si BE, CEFTA, EFTA, Turqia).

Sipas Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, taksat doganore klasifikohen në mënyra të ndryshme¹⁰:

1. Sipas mënyrës së përllogaritjes:

- Ad valorem
- Specifike
- Të kombinuara

2. Sipas funksionit dhe qëllimit:

- Fiskale (sigurojnë të ardhura për buxhetin)
- Mbrojtëse (mbrojtje ndaj industrisë vendase)
- Anti-dumping
- Preferenciale

3. Sipas drejtimit të lëvizjes së mallrave:

- Importi – më e zakonshme
- Eksporti – rrallë e përdorur
- Tranziti – mallrat që kalojnë transit përmes territorit

⁹ <https://dogana.gov.al/d/182/248/0/231/nomenklatura-e-kombinuar-e-mallrave>

¹⁰ [Tabela e Korelimeve 2025](#)

Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjeve.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Vendimin Nr. 651, datë 10.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 470 “Artikujt për përdorim nga të verbrit”

Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 11 të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, përjashtohen nga detyrimet e importit.

Neni 471 “Kushtëzime”

1. Artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në aneksin 12 të shtojcës D bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, do të përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që të importohen nga:a) Vetë personat e verbër për nevojat e tyre; ose b) Institucione apo organizata që merren me edukimin apo dhënien e ndihmës për persona të verbër, të cilat janë të autorizuar nga autoritetet doganore kompetente të marrin këta artikuj me përjashtim nga detyrimet e importit.
2. Përjashtimi i përcaktuar në pikën 1 zbatohet edhe për pjesët e këmbimit/rezervë, pjesë përbërëse apo pjesët ndihmëse përkatëse të artikujve në fjalë, si dhe për veglat që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë këmbimi/rezervë, pjesë përbërëse, pjesë ndihmëse apo veglat të jenë importuar në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë, ose, nëse janë importuar më vonë, me kusht që ato mund të identifikohen se janë të destinuar për artikujt që janë lejuar më parë me përjashtim nga detyrimet e importit, ose të cilat do të përfitonin nga përjashtimi në momentin kur një përjashtim i tillë kërkohet për pjesët specifike të këmbimit, rezervës, komponentëve apo pajisjeve ndihmëse dhe veglave në fjalë.

Udhëzimi i Përbashkët midis Administratës së Përgjithshme të SHSSH me nr. 75/6 prot., datë 22.04.2011 dhe DPD me nr. 5608/6 prot., datë 22.04.2011 “Mbi procedurat e përjashtimit nga

detyrimet doganore të importit për mjetet që u përkasin të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë”

1...Përfitues të përjashtimit nga detyrimet doganore të importit janë:

- a) Të sëmurët paraplegjikë
- b) Të sëmurët tetraplegjikë

4. Përjashtohen nga detyrimet doganore të importit mjetet e të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë.

Udhëzim nr.1, datë 03.01.2018 “Mbi operacionet e privileguara”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD” i ndryshuar.

6. Mallrat që importohen nga invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Objekti i përjashtimit janë: Pajisje, karroca, përfshirë autovetura , deri në 2500 kubikë, të përshtatura për përdorimin e tyre, në pronësi të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik.

Udhëzim nr.3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.

2. Vlerësimi doganor: Vlerësimi doganor është procedura për përcaktimin e vlerës së mallrave dhe shërbimeve që lidhen me to, për qëllime doganore. Vlera doganore e mallrave është e domosdoshme për të përlllogaritur shumën e detyrimeve doganore ad valorem, që duhet të paguhet për mallrat e importuara.

17. Zhdoganimi i automjeteve 17.1 Për zhdoganimin e automjeteve, në rastet kur nuk pranohet transaksioni dhe nuk është i mundur përdorimi i metodave të tjera, vlerësimi bazohet në publikimet e buletineve “Quattroroute”, “Tuttotrasporti”, “Schwackeliste” etj., që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet europiane. 17.2 Vlera e një autoveture gjendet në tabelën “Quattroroute”, duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast, vlera e automjetit nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që gjendet në tabelë.

Vlerësimi i automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, nuk mund të llogaritet më pak se çmimet e pasqyruara si më poshtë vijon: Për autoveturat a) Deri 1400 cc jo më pak se Çmimet 130.000 lekë b) Mbi 1400-1900 cc jo më pak se 200.000 lekë c) Mbi 1900-2500 cc jo më pak se 325.000 lekë d) Mbi 2500-3000 cc jo më pak se 400.000 lekë e) Mbi 3000-4500 cc jo më pak se 500.000 lekë f) Mbi 4500 cc jo më pak se 800.000 lekë.

(Po, sipas përmbajtjes së Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, nuk është parashikuar ndonjë dispozitë e veçantë që të trajtojë lehtësira doganore për personat me aftësi të kufizuara. Ky udhëzim fokusohet në mënyrat e përcaktimit të vlerës doganore të mallrave dhe aplikimin e metodave të vlerësimit në përputhje me rregullat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe konventave ndërkombëtare.)

Referuar parashikimeve ligjore për kategorinë e personave të verbër, përsa i takon përjashtimit nga taksa doganore e importit të automjeteve të përdorura në pronësi të tyre, ligji parashikon që

përrjashtohen vetëm artikujt e projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, por jo mjetet motorike për përdorim vetjak nga kjo kategori. Kjo do të thotë se përrjashtimi nga taksa doganore është i kufizuar vetëm për artikujt e tjerë të përrshtatur për nevojat e personave të verbër dhe jo për automjetet e përrdorura për qëllime personale.

Në analizën e legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri konstaton dhe evidenton faktin se, në zbatim të parashikimeve ligjore sipas fushës së përrgjegjësisë dhe kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përrgjithshme e Doganave, Dega e Doganës Durrës, ka zbatuar dhe aplikuar korrekt taksën doganore në lidhje me aplikimin e subjektit ankues.

Sa më sipër, për sa kohë që legjislacioni aktual në fuqi, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë e tij institucioni, nuk ka parashikuar përrjashtimin e kësaj kategorie nga taksa doganore, institucioni ka detyrimin ligjor për të zbatuar këto parashikime.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh faktet e mësipërme dhe dispozitat përkatëse ligjore, Komisioneri vëren se personat që i përrkasin kategorisë së të verbërve nuk përrjashtohen nga taksa doganore për sa i përrket automjeteve që përrdoren për qëllime personale. Ky përrjashtim është i kufizuar vetëm për artikuj që kanë për qëllim përrparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është parashikuar në aktet nënligjore të legjislacionit të zbatueshëm.

Në këtë kontekst, institucioni ka vepruar në përputhje me detyrimet e tyre ligjore, duke zbatuar normat e taksës doganore në mënyrë të saktë dhe të duhur për rastin e trajtuar nga ankuesi. Drejtoria e Përrgjithshme e Doganave, Dega e Doganës Durrës, ka vepruar duke respektuar legjislacionin aktual dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë fushë, pa përrjashtuar kategorinë e të verbërve nga taksa doganore për automjetet e përrdorura për qëllime personale, pasi nuk është parashikuar ndonjë përrjashtim në ligj për këtë lloj furnizimi.

Për pasojë, veprimet e ndërmarra nga institucioni përkatës në lidhje me taksën doganore janë të pajtueshme me kuadrin ligjor në fuqi dhe përrmbushin detyrimet e vendosura nga ky kuadër.

Ndërrkohë, Komisioneri konstaton se, ka një diferencë në trajtim të personave me aftësi të kufizuara të kategorisë të verbër me personat që i përrkasin kategorisë paraplegjik/tetraplegjik. Kjo diferencë në trajtim vjen për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar.

Grupi i individëve të kategorizuar të verbër, rezulton se trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, pasi nuk gëzojnë të njëjtat lehtësira lidhur me përrjashtimin nga detyrimet doganore të importit për mjete me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, në pronësi të tyre, që legjislacioni në fuqi garanton për grupin e personave që kanë statusin e paraplegjik/tetraplegjik apo të veteranit të luftës antifashiste.

Në këtë këndvështrim, këta individë janë vendosur në kushte më pak të favorshme për të siguruar jetesën e pavarur, si një parakusht për të gëzuar të drejta dhe liri të tjera, në raport me grupin e

individëve me aftësi të kufizuara që gëzojnë të drejtën për të përfituar nga përjashtimi i taksës doganore të importit të automjeteve të përdorura në pronësi të tyre.

Në lidhje me këto konstatime mbi diferencimin në trajtim të personave me aftësi të kufizuara të diferencës në trajtim që vjen për shkak të llojit të aftësisë së kufizuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e ka shprehur qëndrimin e tij me Rekomandimin nr. 1613 Prot., datë 22.11.2021¹¹ me anë të cilit ka rekomanuar marrjen e masave nga institucionet kompetente, për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore apo nënligjore, lidhur me përfshirjen e kategorisë së personave me aftësi të kufizuara me sindromën down dhe çrregullime të spektrit autik që kanë në pronësi të tyre një automjet, në kategoritë përfituese të personave me AK, të cilët përjashtohen nga detyrimet doganore të importit për mjete me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, në pronësi të tyre, me qëllim sigurimin e trajtimit të tyre në mënyrë të barabartë e të padiferencuar, me kategoritë e tjera të personave me AK që rezultojnë përfitues në bazë të akteve konkrete ligjore dhe nënligjore.

Në përfundim të analizës së legjislacionit në fuqi dhe në funksion të kompetencave të tij kushtetuese e ligjore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se mungesa e parashikimeve të posaçme që garantojnë përjashtime nga detyrimet doganore për personat me aftësi të kufizuara të kategorisë së të verbërve, si dhe duke marrë në konsideratë diferencën në trajtim ndaj kësaj kategorie në raport me kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga këto lehtësira, përbën një boshllëk ligjor që çon në trajtim të pabarabartë ndaj kësaj kategori. Në këtë kontekst, dhe në përputhje me detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri do të vlerësojë mundësinë e ndërmarrjes së një nisme për plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës, me qëllim krijimin e parashikimeve specifike që garantojnë përfshirjen e kësaj kategorie në skemat përkatëse të përjashtimeve nga detyrimet doganore, në funksion të respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Sa më sipër, në vijim të shqyrtimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe parashkrimeve të bëra nga institucionet përkatëse, rezulton se për kategorinë e personave të verbër, legjislacioni aktual në Republikën e Shqipërisë nuk parashikon përjashtim nga detyrimet doganore për importin e automjeteve të përdorura për përdorim vetjak. Përjashtimet e parashikuara në këtë fushë lidhen vetëm me artikuj të projektuar posaçërisht për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të kësaj kategorie, siç përcaktohet në Kodin Doganor dhe aktet nënligjore përkatëse. Në këto kushte, Dega e Doganës Durrës ka vepruar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, duke refuzuar kërkesën për përjashtim nga detyrimet doganore për automjetin në pronësi të subjektit ankues, për shkak se kjo kategori nuk është përfituese e një lehtësie të tillë në kuptim të ligjit. Veprimet e ndërmarra nga autoriteti doganor janë të mbështetura në legjislacionin ekzistues dhe përfaqësojnë zbatim korrekt të normave që rregullojnë fushën përkatëse.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm, si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se z. S. P., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë,

¹¹ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/11/Rekomandim-nr.-1613-date-23.11.2021-Per-perjashtimin-nga-detyrimi-doganor-per-importin-e-mjeteve-qe-u-perkasin-personave-me-AK.pdf>

të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e subjektit kundër të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. S. P., në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

